



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KRYETARI
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Shijak, më ____ . ____ . 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje pjese kembimi per nevoja te bashkise Shijak

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjese kembimi per automjete, furgone dhe makina tansporti mallrash- 34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

8.006.218 (tetemilion e gjashte mije e dyqind e tetembedhjete) leke **Monedha, pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: Nga data e nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Shijak brenda 20 (njetete) ditëve punë nga lidhja e kontratës.

BURIMI I FINANCIMIT: TE ARDHURA NGA BUXHETI I SHTETIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 8, pika 1 të DST “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për

të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gjurmës "c" të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se **40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si; referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Në rast se, ofertuesi nuk është prodhues/ ose tregëtues i autorizuar duhet të paraqesë deklaratë me shkrim midis paleve nga një tregëtues i ketyre mallrave për artikujt objekt prokurimi

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket (katalogjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose angleze).

BATERITË

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Bateri 12V 100AH-EN 1000	cope	7
2	Pole baterish (+:-)	cope	20
3	Bateri 12V 120AH-800 A(EN)	cope	2
4	Bateri 12V, 180 AH, 1000(EN)	cope	6
5	Bateri 12V 80 AH	cope	1

GOMAT

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma industriale 10-20R (EMMB 38)	cope	8
2	Goma te para 12.5/80-18 (14 shtresa) tipi TL	cope	2
3	Goma 18-4-26 me 4 shtresa teli (480/80-26) sipas terrenit, tipi TL	cope	2
4	Goma 195-70R-15C tipi TL	cope	8
5	Goma 235-75R-17.5	cope	6
6	Goma 225-70-15C	cope	4
7	Goma 285-70R-19.5	cope	6
8	Goma 175-70 R-14	cope	2

9	Goma 315/80R / 22.5	cope	2
10	Goma 275/45R-20 4 stinet XL tipi TL	cope	4
11	Gomardare me ventil hekuri 10-20 R	cope	16
12	Fasheta gomardaresh(mbrojtëse)	cope	8
13	Pompe lavazhi 200 bar, 380 V e kompletuar me te gjitha aksesorët	cope	1

VAJRAT DHE ARTIKUJ TË TJERË			
N r.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Vaj motorri SAE 15-40W (CI-4/CF/SL) ACEA E-7	liter	200
2	Vaj hidrauliku SAE 46W (iso-VG) DIN 51524 (Part II, Part III, Cincinati Milacron P-68, P-69, P-70), ose ekuivalent	liter	600
3	Vaj kambio diferenciali SAE 20-30W	litra	100
4	Vaj kambio automatike manuale SAE 10-30W	litra	30
5	Vaj MHL 10 W (alkol industrial)	litra	5
6	Vaj diferenciali SAE 90 W	litra	2
7	Vaj kambio diferenciali SAE 90W (GL-1)	litra	72
8	Vaj motorri SAE 10-40 W (CI-4) ACEA A3/B4, E7	litra	54
9	Vaj hidraulik grupi timoni SAE 10 W (Allison C3 CAT TO-2, ose ekuivalent)	litra	24
10	Vaj motorri SAE 5-30W (SL/CF ACEA C3)	litra	20
11	Vaj kambio automatike ATF	litra	10
12	Vaj kambio automatike Dekson 3 (GM-ALLISON C-4)	litra	35

1 3	Vaj motorri SAE 20-50 W (CF-4/CF/SG) Allison C3 (ose ekuivalent)	litra	25
--------	---	-------	----

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se, ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përftimin e mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se, çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e artikujve të sipërcituar, të njohë kapacitetet tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standartet e përcaktuara dhe duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/ distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015, ose ekuivalente për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;

b) ISO 14001:2015, ose ekuivalente lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit

c) ISO 45001:2018, ose ekuivalente lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, si dhe në mbështetje të nenit 79, pika 1, ku citohet si vijon: ”1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë...”
Gjithashtu bazuar edhe në neni 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Për vetë natyrën dhe rëndësinë e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që, operatorët si zbatues të kontratës, të kryejnë veprimtarinë në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto cerifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve, reputacionit dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë. Konkretisht:

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standartet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjediore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi

të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqëndrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë, për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) është standart ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për cdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se, cdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci më tepër, që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot, si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e furnizimit me mallin, objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar për periudhën e fundit të deklarimit stafin e tij teknik, specialist të fushës me eksperiencë, si më poshtë::

- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektroaut

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Kontratë individuale të punës për të vërtetuar marrëdhënien e punësimit dhe një dokument (dëshmi kualifikimi/ certifikatë / diplomë) për të vërtetuar kualifikimin profesional të punonjësve në fushën përkatëse.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu bazuar në VKM-në nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” të rishikuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personlin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës,

. Konkretisht:

- 1 (një) saldator, i cili është i nevojshëm për zërat e preventivit ”Saldime me argon”, ”Saldime me alumin” dhe ”Saldime me oksigjen”
- 1 (një) elektroaut, i cili është i nevojshëm për zërat e preventivit ”Shërbime elektrike”, ”Riparime elektronike me kompjuter” dhe ”Riparim i gomave në destinacion”.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht -- 2 persona**, për muajin **Shkurt 2025**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të vërtetojë disponimin e numrit minimal të punonjësve nëpërmjet dokumentave si më poshtë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur në raport me sasitë e mallrave që do të furnizohen, shërbimeve që do të kryhen për montimin dhe mirëmbajtjen e tyre brenda periudhës së garancisë dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton , në pronësi ose me qira, për transportimin e mallrave objekt prokurimi – 1 copë.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit , leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni dhe certifikatë transporti Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontratë shit-blerje ose kontratë dhurimi) , ndërsa për mjetet me qira të paraqitet kontrata e qirasë.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Makineritë janë të nevojshme për transportimin e mallrave objekt prokurimi dhe janë përcaktuar në raport me sasinë e mallrave që do të furnizohen, shërbimeve që do të kryhen dhe me kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se *“Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”*

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se *“Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”*

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: *“Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim.”*

Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se :
“Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qira 1 (një) ambient/servis ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimeve që do të prokurohen.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë: Certificate pronësie/Kontrate shitblerje/Kontrate qiraje.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion një ambient pune ku të ushtrojnë aktivitetin për kryerjen e shërbimeve pjesë e objektit të prokurimit, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

** Specifikimet teknike bashkëlidhur janë hartuar nga Njësia e Prokurimit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

NJËSIA E PROKURIMIT